



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AVOKATI I POPULLIT

NJOFTIM

*Mbi datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore të kandidatëve për pozicionet “Komisioner” në:
Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor dhe në
Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre pranë institucionit të Avokatit të Popullit*

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe të Rregullores për Procedurat dhe Kriteret për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit, miratuar me Urdhrin e Avokatit të Popullit nr.199 datë 09.12.2021¹, Institucioni i Avokatit të Popullit njofton:

Seanca dëgjimore me kandidatet do të zhvillohet ditën e Hënë, më datë 27.02.2023, duke filluar nga ora 10:00, në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit.

Në zbatim të neneve 9,10 dhe 12 të Rregullores për Procedurat dhe Kriteret për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin një *propozim/platformë* të qartë në përputhje me dokumentat dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtarë e kombëtarë, si dhe me Strategjinë, Planin e Veprimit dhe Raportet Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, ku të përfshihet:

- prezantimi i kandidaturës;
- prezantimi i këndvështrimit mbi problematikat e fushës në të cilën aplikohet;
- propozimi mbi çështjet që duhet të trajtohen me përparësi;
- propozimi mbi politikën në fushën specifike të të drejtave të njeriut;
- propozimi mbi mënyrën e manaxhimit dhe drejtimit të seksionit/mekanizmit etj.

¹<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Urdher%20199,%20date%2009122021%20per%20miratimin%20e%20rregullores%20per%20procedurat%20dhe%20kriteret%20per%20perzgjedhjen%20e%20kandidateve%20per%20komisioner%20ne%20institucionin%20e%20Avokatit%20te%20Popullit.pdf>